# FLETORJA ZYRTARE

# E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

| **Nr. 58** | **2001** | **Dhjetor** |
|---|---|---|


P Ë R M B A J T J A


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr.8840<br>datë 11.12.2001 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr.8508, datë 7.7.1999; nr.8519, datë 30.7.1999; nr.8552, datë 18.11.1999; nr.8581, datë 17.2.2000; nr. 8651, datë 28.7.2000 dhe nr. 8713, datë 15.12.2000 ........................................................................ | 1825 |
| Ligj nr.8841<br>datë 11.12.2001 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", ndryshuar me ligjin nr.8711, datë 15.12.2000 .................................................... | 1831 |
| Ligj nr.8842<br>datë 11.12.2001 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8313, datë 26.3.1998 "Për tatimin mbi biznesin e vogël", ndryshuar me ligjin nr.8715, datë 15.12.2000 .................................................... | 1834 |
| Ligj nr. 8843<br>datë 11.12.2001 | Për disa ndryshime në ligjin nr.8474, datë 14.4.1999 "Për miratimin e nomenklaturës dhe të tarifës doganore", ndryshuar me ligjin nr.8558, datë 22.12.1999 dhe me ligjin nr.8712, datë 15.12.2000 ........................................................................ | 1837 |

| | | |
|---|---|---|
| Ligj nr.8844 datë 11.12.2001 | Për një ndryshim në ligjin nr.8720, datë 26.12.2000 "Për krijimin e Policisë Financiare",ndryshuar me aktin normativ nr.2, datë 27.4.2001, miratuar me ligjin nr.8796, datë 14.5.2001 ........................................................................ | 1839 |
| Ligj nr.8845 datë 11.12.2001 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", ndryshuar me ligjet nr.8070, datë 15.2.1996; nr.8126, datë 9.7.1996; nr.8130, datë 22.7.1996; nr.8149, datë 11.9.1996; nr.8160, datë 7.11.1996; nr.8186, datë 23.1.1997; nr.8201, datë 20.3.1997; nr.8140, datë 16.9.1997; nr.8445, datë 21.1.1999; nr.8505, datë 7.7.1999; nr.8714, datë 15.12.2000 dhe nr.8779, datë 26.4.2001......................................................................... | 1840 |
| Ligj nr.8846 datë 11.12.2001 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8710, datë 15.12.2000 ...... | 1842 |
| Ligj nr.8847 datë 19.12.2001 | Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002 ...................................... | 1847 |
| Ligj nr. 8848 datë 19.12.2001 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8437, datë 28.12.1998 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr.8507, datë 7.7.1999, nr.8595, datë 6.4.2000 dhe nr. 8716, datë 15.12.2000................................. | 1851 |

**L I G J**
**Nr. 8840, datë 11.12.2001**

# PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8435, DATË 28.12.1998 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJET NR.8508, DATË 7.7.1999; NR.8519, DATË 30.7.1999; NR.8552, DATË 18.11.1999; NR.8581, DATË 17.2.2000; NR. 8651, DATË 28.7.2000 DHE NR. 8713, DATË 15.12.2000

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr.8508, datë 7.7.1999; nr.8519, datë 30.7.1999; nr.8552, datë 18.11.1999; nr.8581, datë 17.2.2000 ; nr.8651, datë 28.7.2000 dhe nr.8713, datë 15.12.2000, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 të bëhen këto ndryshime:
Pikat 7 dhe 9 të ndryshohen si më poshtë:
"7. Taksat për pajisjen me leje drejtimi për drejtim automjeti.
9. Taksa për përdorimin e numrit telefonik" .
Pika 23 ndryshohet si më poshtë:
"23. Taksa për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasurinë e luajtshme (automjetet).".

Neni 2

Në nenin 6 të bëhen këto ndryshime:
Shkronjat "e", "f " , "gj", "k", "q" dhe "s" të pikës 1 "Taksat kombëtare", ndryshohen si më poshtë:
"e. Taksa për importimin e automjeteve të përdorura caktohet:
Për mjetet e prodhuara deri më 31 dhjetor 1990.
1. Për autoveturat: 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.
2. Për mjetet e tjera për transportimin e jo më shumë se 10 personave, furgonë, mikrobusë dhe mjete të tjera për transportimin e mallrave me peshëmbajtje deri në 5 tonë: 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë.
3. Për autobusët dhe mjetet e tjera për transportimin e mallrave me peshëmbajtje mbi 5 tonë: 100 000 (njëqind mijë) lekë.
4. Për traktorët rrugorë (kokat tërheqëse) 40 000 (dyzet mijë) lekë.
Për mjetet e prodhuara nga 1 janari 1991:
1. Për autovetura: 40 000 (dyzet mijë) lekë.
2. Për mjetet e tjera për transportimin e jo me shumë se 10 personave, furgonë, mikrobusë dhe mjete të tjera për transportimin e mallrave me peshëmbajtje deri në 5 tonë: 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
3. Për autobusët dhe mjetet e tjera për transportimin e mallrave me peshëmbajtje mbi 5 tonë: 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
4. Për traktorët rrugorë (kokat tërheqëse): 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.
f. Taksat për pajisjen me leje drejtimi për drejtimin e automjeteve caktohen:

| | |
|---|---|
| 1. Për leje drejtimi të kategorisë A…………………. | 3 000 ( tre mijë) lekë |
| 2. Për leje drejtimi të kategorisë B… ………………. | 4 500 (katër mijë e peseqind) lekë |
| 3. Për leje drejtimi të kategorisë C…………………. | 2 000 (dy mijë) lekë |
| 4. Për leje drejtimi të kategorisë D… … …………. | 3 000 ( tre mijë) lekë |
| 5. Për leje drejtimi të kategorive BE,CE dhe DE…… | 3 000 ( tre mijë) lekë |

gj. Taksa për përdorimin e numrit telefonik:

1. Për telefoninë kabllore, nga çdo zotërues në masën 200 (dyqind) lekë në vit.

2. Për telefoninë celulare me kontratë, nga çdo zotërues në masën 400 (katërqind) lekë në vit.

3. Për telefoninë celulare me parapagim (kartë), nga çdo zotërues në masën 700 (shtatëqind) lekë vetëm në çastin e shitjes së numrit.

k. Taksat vjetore për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive caktohen sipas lidhjes 11, që i bashkëlidhet këtij ligji.

q. Taksa e mbikalimeve ajrore të avionëve mbi territorin e Republikës së Shqipërisë llogaritet në bazë të njësisë "unit rate" (kosto bazë) që caktohet çdo vit nga Eurokontrolli. Vetëm për vitin 2002 taksa e mbikalimeve ajrore do të mbetet në masën 100 dollarë për çdo mbikalim.".

"s. Taksa e kalimit të së drejtës të pronësisë të pasurisë së luajtshme (automjete) është në masën 2 për qind të vlerës së kalimit të pasurisë dhe ajo paguhet në çastin e kryerjes së aktit të kalimit të pronësisë. Për mjetet e prodhuara deri në 10 vjet nga çasti i kalimit të pronësisë, taksa është 2 për qind e vlerës, por jo më pak se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, ndërsa për mjetet e prodhuara mbi 10 vjet nga çasti i kalimit të pronësisë, taksa është dy për qind e vlerës, por jo më pak se 5 000 (pesë mijë) lekë.".

Në paragrafin e fundit të shkronjës "t" të pikës 1, pas fjalëve "personat fizikë dhe juridikë", fjalët "që shesin pasuri të tilla" zëvendësohen me fjalët "që kalojnë këtë të drejtë".

## Neni 3

Në fund të pikës II "Taksat vendore" të nenit 6 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Për Bashkinë e Tiranës, niveli i taksave të shkronjës "b" pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, shkronjës "dh", pika 1, 2 dhe shkronjës "e" pika 1, të përllogaritet sipas ndarjes së territorit në zonat A, B, C si më poshtë:

- Për zonën A niveli i taksës shumëzohet me koeficientin 1, 2
- Për zonën B niveli i taksës shumëzohet me koeficientin 1,1
- Për zonën C niveli i taksës shumëzohet me koeficientin 1.

Zonat A, B dhe C klasifikohen nga zyrat e urbanistikës në Bashkinë e Tiranës, në përputhje me zhvillimin urbanistik dhe ekonomik të tyre. Këto zona miratohen nga Këshilli i Rregullimit të Territorit në Bashkinë e Tiranës".

## Neni 4

Në pikën "A" "Për taksat kombëtare" të nenit 8 bëhen këto ndryshime:

Pikat 1, 3, 12, 17 dhe 20 ndryshohen si më poshtë:

"1. Për taksat portuale (kapitenerisë së porteve) 4 për qind

3. Për taksën vjetore të tonazhit të automjetit për aks,22 për qind
e cila ndahet:
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve
të Transportit Rrugor 20 për qind
- Drejtoria e Qarkullimit Rrugor pranë Ministrisë së
Rendit Publik2 për qind

12. Për taksën për pajisje me leje drejtimi për drejtim
automjeti 5 për qind

17. Për taksën e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve,22 për qind
e cila ndahet:
-Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit
Rrugor20 për qind
-Drejtoria e Qarkullimit Rrugor pranë Ministrisë
së Rendit Publik 2 për qind
20. Nga të ardhurat e vjela nga taksa e mbikalimeve
ajrore në territorin e Republikës së Shqipërisë përqindja
që do t'i jepet Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror të jetë80 për qind
Nga kjo përqindje jo më pak se 70 për qind të jetë për
investime.".

Pas pikës 23 shtohet pika 24 me këtë përmbajtje:

"24. Për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për
pasurinë e luajtshme (automjetet) 8 për qind.".

Pika 3 e paragrafit të fundit të nenit 8 riformulohet si më poshtë:

"3. Për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksës.".

Neni 5

Shkronjat "e", "g" dhe "q" të pikës "A. Për taksat kombëtare:" të nenit 9 ndryshohen si vijon:

"e. Për taksën për pajisje me leje drejtimi për drejtim automjeti, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor."

"g. Për taksën për përdorimin e numrit telefonik, kabllor e celular, ngarkohen operatorët përkatës që operojnë në Republikën e Shqipërisë".

"q. Për taksën për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasurinë e luajtshme (automjetet) ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.".

Neni 6

Në fund të pikës 16 të nenit 10 shtohen fjalët:

"... Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore".

Pas pikës 16 të nenit 10 shtohen pikat 17, 18 dhe 19 me këtë përmbajtje:

"17. Përjashtohen nga pagimi i taksës vjetore për regjistrimin e përvitshëm të automjeteve, mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare që gëzojnë statusin diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit.

18. Përjashtohen nga pagimi i taksës vjetore të tonazhit për aks:

a) Mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare që gëzojnë statusin diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit.

b) Automjetet në pronësi të personave, fizikë ose juridikë, të cilët deklarojnë brenda muajit janar të vitit në vazhdim, se nuk do të qarkullojnë për vitin kalendarik, vetëm pasi të kenë dorëzuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit.

19. Përjashtohen nga pagimi i taksës për pajisjen me leje drejtimi për drejtim automjeti, personeli i misioneve diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit.

Neni 7

Pikat 5 dhe 14 të nenit 10 të këtij ligji shfuqizohen.

Neni 8

Lidhjet nr.3 dhe nr.5 të ligjit zëvendësohen me lidhjet që i bashkëlidhen këtij ligji.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3198, datë 24.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

LIDHJA NR. 3
TAKSAT VJETORE TË TONAZHIT PËR AKS TË MJETEVE

| Nr. | Tipi i mjetit | Masa e taksës për një aks në lekë |
|---|---|---|
| 1. | Autoveturë dhe mikrobus me më shumë se (4 + 1 ) dhe me më pak ose e barabartë me (8 + 1) vende | 5000 |
| 2. | Autobus me më pak ose i barabartë me (32 + 1) vende | 10000 |
| 3. | Autobus me më pak ose i barabartë me (42 + 1) vende | 13000 |
| 4. | Autobus me më shumë se (42 + 1) vende | 15000 |
| 5. | Furgon dhe kamionçinë me peshë maksimale të autorizuar më të vogël ose të barabartë me 3 tonë | 5000 |
| 6. | Furgon dhe kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 3 dhe deri ose të barabartë me 3,5 tonë | 10000 |
| 7. | Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 3,5 dhe deri ose të barabartë me 7,5 tonë | 15000 |
| 8. | Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 7,5 dhe deri ose të barabartë me 18 tonë | 18000 |
| 9. | Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 18 tonë | 23000 |
| 10. | Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor rrugor, karkalec etj.) me peshë maksimale të autorizuar më të vogël ose të barabartë me 7,5 tonë | 15000 |
| 11. | Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor rrugor, fadromë etj.) me peshë maksimale të autorizuar mbi 7,5 tonë | 18000 |
| 12. | Mjete ndërtimi (autovinça, autobetoniere etj.) me peshë maksimale të autorizuar deri ose të barabartë me 7,5 tonë | 20000 |
| 13. | Mjete ndërtimi (autovinça, autobetoniere etj.) me peshë maksimale të autorizuar mbi 7,5 dhe deri ose të barabartë me 18 tonë | 24000 |
| 14. | Mjete ndërtimi (autovinça, autobetoniere, etj.) me peshë maksimale të autorizuar mbi 18 tonë | 30000 |
| 15. | Rimorkio me peshë maksimale të autorizuar më të vogël ose të barabartë me 7 tonë | 7500 |
| 16. | Rimorkio me peshë maksimale të autorizuar mbi 7 tonë | 10000 |

Shënim:

Vlerat e taksave në tabelën e mësipërme janë vetëm për një aks. Pagesa e plotë e taksës do të jetë sa vlera e taksës për një aks shumëzuar për numrin e akseve.

## LIDHJA NR. 5
## TAKSAT VJETORE PËR REGJISTRIMIN E PËRVITSHËM TË MJETEVE

| Nr. | Tipi i mjetit | Masa e taksës në lekë |
|---|---|---|
| 1. | Motomjete | 600 |
| 2. | Autoveturë me më pak ose e barabartë me ( 4 + 1) vende | 2400 |
| 3. | Autoveturë dhe mikrobus me më shumë se (4 +1) dhe me më pak ose e barabartë me (8 +1) vende | 4800 |
| 4. | Autobus me më pak ose i barabartë me (32 + 1) vende | 6000 |
| 5. | Autobus me më pak ose i barabartë me (42 + 1) vende | 7200 |
| 6. | Autobus me më shumë se (42 + 1) vende | 8400 |
| 7. | Autobus artikular me më shumë se (42 + 1) vende | 9000 |
| 8. | Furgon dhe kamion me peshë maksimale të autorizuar deri në 3,5 tonë | 3600 |
| 9. | Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 3,5 dhe deri ose e barabartë me 7,5 tonë | 4800 |
| 10. | Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 7,5 dhe deri ose e barabartë me 18 tonë | 6000 |
| 11. | Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 18 tonë | 8000 |
| 12. | Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor rrugor, karkalec etj. ) me peshe maksimale të autorizuar më të vogël ose të barabartë me 7,5 tonë | 3000 |
| 13. | Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor rrugor, fadromë, autovinç etj.) me peshë maksimale të autorizuar mbi 7,5 tonë | 3600 |
| 14. | Rimorkio me peshë maksimale të autorizuar më të vogël ose të barabartë me 7 tonë | 3000 |
| 15. | Rimorkio me peshë maksimale të autorizuar mbi 7 tonë | 4000 |

LIDHJA NR.LL
TAKSAT VJETORE PËR SHËRBIMET E TRANSMETIMEVE RADIO E TELEVIZIVE

Për transmetuesit ose përsëritësit televizivë analogë tokësorë, radio FM tokësore , radio AM të operatorëve privatë radio e televizivë, kombëtarë e vendorë

1.Për çdo transmetues ose përsëritës televiziv analogjik tokësor

| | |
|---|---|
| a) me fuqi të rrezatuar deri 10W | 1500 lekë në vit |
| b) me fuqi të rrezatuar deri 100 W | 6000 lekë në vit |
| c) me fuqi të rrezatuar deri 1000W | 24000lekë në vit |
| d) me fuqi të rrezatuar deri 10000W | 48000lekë në vit |
| e) me fuqi të rrezatuar mbi 10000W | 60000lekë në vit |

2.Për çdo transmetues ose përsëritës radio FM tokësore

| | |
|---|---|
| a) me fuqi të rrezatuar deri 10 W | 300lekë në vit |
| b) me fuqi të rrezatuar deri 100 W | 1200 lekë në vit |
| c) me fuqi të rrezatuar deri 1000W | 4800 lekë në vit |
| d) me fuqi të rrezatuar deri 10000W | 9600 lekë në vit |
| e) me fuqi të rrezatuar mbi 10000W | 12000lekë në vit |

3. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.d, 1.e, 2.b, 2.c, 2.d, 2.e, mbulon mbi gjysmën e qytetit të Tiranës, atëherë taksa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 5.

4.Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, l.d, 1.e, 2.b, 2.c, 2.d, 2.e, mbulon mbi gjysmën e një qyteti me popullsi mbi 100 000 banorë, atëherë taksa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 2.

5. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, l.c, l.d, 1.e, 2.b, 2.c, 2.d, 2.e, mbulon mbi gjysmën e një qyteti me popullsi 50000 deri 100 000 banorë, atëherë taksa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 1,5.

6. Në qoftë se transmetuesit ose përsëritësit 1.b, l.c, 1.d, 1.e, 2.b, 2.c, 2.d, 2.e, mbulojnë dy ose më shumë qytete të cituara në pikat 3, 4, 5, atëherë taksa e llogaritur në këto pika shumëzohet vetëm një herë me koeficientin më të lartë.

7. Për çdo transmetues AM 200 000 lekë në vit.

Operatorët radio dhe/ose televizivë të ritransmetimit të programeve të huaja me përsëritës të licencuar nga KKRT paguajnë vetëm 20% të taksave të përcaktuara më sipër.

**L I G J**
**Nr. 8841, datë 11.12.2001**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8711, DATË 15.12.2000**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", ndryshuar me ligjin nr.8711, datë 15.12.2000, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 2 "Përkufizime" ndryshohet si më poshtë:

"Neni 2
**Përkufizime**

1) Për qëllim të këtij ligji:

a) emërtimi "tatimpagues" nënkupton çdo person që i nënshtrohet detyrimit të tatimit sipas këtij ligji;

b) emërtimi "person" nënkupton:

i) një "individ" (person fizik jotregtar sipas Kodit Civil);

ii) një "person fizik" (person fizik tregtar);

iii) një "person juridik" (shoqëri tregtare e themeluar sipas ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", personat e tjerë juridikë të themeluar sipas Kodit Civil, të cilët ushtrojnë veprimtari fitimprurëse në Republikën e Shqipërisë, si dhe personat e tjerë juridikë të themeluar ose të njohur si të tillë me ligje të veçanta);

iv) një "ortakëri", si bashkim personash, fizikë dhe juridikë, për të kryer një veprimtari të përkohshme, të përbashkët me qëllim fitimi, që nuk krijohet si person juridik më vete në format e parashikuara nga ligji nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", nga Kodi Civil ose nga ligje të veçanta.

c) dy persona konsiderohen "persona të lidhur", nëse njëri prej tyre vepron ose mund të veprojë në përputhje me drejtimet, kërkesat, sugjerimet apo dëshirat e personit tjetër ose që të dy veprojnë ose mund të veprojnë në përputhje me drejtimet, kërkesat, sugjerimet apo dëshirat e një personi të tretë, pavarësisht nëse këto drejtime, kërkesa, sugjerime apo dëshira, janë komunikuar (deklaruar). Në veçanti do të konsiderohen si "persona të lidhur" personat e mëposhtëm:

i) bashkëshortët, prindërit e tyre apo fëmijët e tyre;

ii) një shoqëri tregtare apo çdo person, që zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi 50 për qind ose më shumë, në vlerë apo në numër, të aksioneve apo të fuqisë votuese të një shoqërie tjetër.

iii) dy ose më shumë shoqëri, nëse një person i tretë zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi 50 për qind ose më shumë, në vlerë apo në numër, të aksioneve ose të fuqisë votuese në secilën shoqëri.

2. a) Emërtimi "Seli e Përhershme", nënkupton një vend të caktuar biznesi, nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht apo pjesërisht biznesi i një personi.

b) Do të konsiderohen seli të përhershme: një zyrë administrative, një degë, një fabrikë, një punishte, një minierë apo çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore, si dhe një shesh ndërtimi, rikonstruksioni, instalimi apo montimi.

c) Një person nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme nëse ai:

i) përdor mjediset vetëm për qëllim magazinimi apo ekspozimi të mallrave që i përkasin atij personi;

ii) mban një gjendje mallrash që i përkasin atij personi vetëm me qëllim magazinimi apo ekspozimi;

iii) mban një gjendje mallrash që i përkasin atij personi vetëm për qëllim përpunimi nga një person tjetër;

iv) mban një vend të caktuar biznesi vetëm për qëllim blerjeje mallrash apo për mbledhje të dhënash për biznesin e atij personi;

v) mban një vend të caktuar biznesi vetëm për qëllim ushtrimin e çdo veprimtarie përgatitore apo ndihmëse për biznesin e atij personi.

ç) Pavarësisht nga dispozitat e shkronjave "a" dhe "b" të sipërpërmendura, kur një agjent i ndryshëm nga një agjent i pavarur, ndaj të cilit zbatohet shkronja "d" e përmendur më poshtë, vepron në emër të një personi, ka dhe zakonisht ushtron një autoritet për të përfunduar kontrata në emër të atij personi. Ai person do të trajtohet njëlloj sikur të kishte një seli të përhershme në vendin ku ushtrohen këto veprimtari, për çdo veprimtari që kryen agjenti për atë person, përveç rasteve kur veprimtaritë e agjentit kufizohen në shkronjën "c" të përmendur më sipër, të cilat edhe kur ushtrohen nëpërmjet një vendi të caktuar biznesi, nuk do ta bënin atë vend të caktuar biznesi një seli të përhershme.

d) Një person nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme kur ai ushtron biznesin e tij nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti komisioner të përgjithshëm, apo çdo agjenti tjetër me një status të pavarur, me kusht që këta agjentë të veprojnë në kuadër të zakonshëm të biznesit të tyre.

dh) Fakti që një shoqëri kontrollon ose kontrollohet prej një shoqërie tjetër, nuk përbën në vetvete arsye për ta quajtur secilën shoqëri seli të përhershme të tjetrës.".

Paragrafi i tretë i nenit 3 "Rezidenca", ndryshohet si më poshtë:

“Personi juridik i cili:

a) ka selinë qendrore (zyrën qendrore) në Republikën e Shqipërisë;

b) ka vendin e menaxhimit efektiv të biznesit në Republikën e Shqipërisë.".

Neni 3

Në fund të shkronjës "a" të nenit 16 "Fusha e veprimit të tatimit mbi fitimin", shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"dhe që janë regjistruar për TVSH-në.".

Neni 4

Pas shkronjës "d" të nenit 31 shtohet shkronja "dh" me këtë përmbajtje:

"dh) Mosplotësimi i saktë dhe moskuadrimi i të dhënave të pasqyrave të bilancit kontabël, anekseve të tij dhe të dhënave të tjera të kërkuara nga ligji nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.”.

Neni 5

Pas shkronjës "ç" të nenit 32 "Dënimet", shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:

"d) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjës "dh" të nenit 31, dënohen me gjobë:

- në masën 25 mijë lekë individi, përgjegjësi që është ngarkuar nga tatimpaguesi për plotësimin e pasqyrave;

- në masën 50 mijë lekë eksperti kontabël i autorizuar në rast se subjekti plotëson kushtet për ekspertizë kontabël.

Për gjobën e vendosur ndaj ekspertit kontabël të autorizuar njoftohet Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.".

Neni 6

Shkronja "h" e nenit 21 "Shpenzime të panjohura", ndryshohet si më poshtë:

"h) shpenzimet e përfaqësimit që tejkalojnë shumën 2 për qind të fondit vjetor të pagave të tatimpaguesit.".

Neni 7

Në fund të paragrafit 4 të nenit 30 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Përjashtimisht tatimpaguesit të cilët fillojnë veprimtarinë në periudhën vijuese dhe ushtrojnë veprimtari në sferën prodhuese, nuk do t'i nënshtrohen parapagimit të detyrimit për tatimin mbi fitimin për një periudhë 6-mujore ose për periudhën e mbetur deri në fund të vitit vijues, nëse kjo periudhë është edhe më e vogël se 6 muaj.".

Neni 8

Në fund të shkronjës "d" të pikës 1 të nenit 33 "Mbajtja e tatimit mbi të ardhurat", shtohen fjalët:

"si dhe pagesat për qiratë".

Neni 9

Pas pikës 3 të nenit 34 "Mbajtja përfundimtare e tatimit", shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Një person i cili i paguan një individi rezident të ardhura nga kontratat e qirasë, mban tatimin për këto të ardhura në masën 10 për qind. Ky do të jetë tatimi përfundimtar i pagueshëm për këto të ardhura nga qiradhënia dhe kushtet e parashikuara në nenin 8, dhe ato në paragrafin e dytë të nenit 9 të këtij ligji, nuk zbatohen.".

Neni 10

Pas pikës 6 të nenit 38 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

"7. Tatimpaguesit që kanë gëzuar lehtësi dhe përjashtime me ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", me ligjin nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit" dhe me dekretin nr.782, datë 22.2.1994 "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve", do t'i gëzojnë lehtësitë, sipas kushteve të parashikuara në këto ligje.".

Neni 11

Pasqyra nr.1 që i bashkëlidhet ligjit ekzistues, zëvendësohet me pasqyrën nr.1 që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3199, datë 24.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

PASQYRA NR.1
TABELA E TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE NGA PAGAT

| E ARDHURA E TATUESHME (PËR MUAJ) | | TATIMI MBI TË ARDHURËN PERSONALE | |
|---|---|---|---|
| Mbi (në lekë) | Deri në (në lekë) | Lekë | Përqindje |
| 0 | 14 000 | | Pragu përjashtues |
| 14 000+ | 30 000 | 0 | +5% të shumës mbi 14 000 |
| 30 000+ | 60 000 | 800 | +10% të shumës mbi 30 000 |
| 60 000+ | 80 000 | 3 800 | +15% të shumës mbi 60 000 |
| 80 000+ | 100 000 | 6 800 | +18% të shumës mbi 80 000 |
| 100 000+ | 125 000 | 10 400 | +20% të shumës mbi 100 000 |
| 125 000+ | 150 000 | 15 400 | +23% të shumës mbi 125 000 |
| 150 000+ | Më tepër | 21 150 | +25% të shumës mbi 150 000 |

**L I G J**
**Nr. 8842, datë 11.12.2001**

# PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8313, DATË 26.3.1998 "PËR TATIMIN MBI BIZNESIN E VOGËL", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8715, DATË 15.12.2000

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8313, datë 26.3.1998 "Për tatimin mbi biznesin e vogël", ndryshuar me ligjin nr.8715, datë 15.12.2000, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Paragrafi i parë i nenit 3 "Tatimi me kuotë fikse", ndryshohet si më poshtë:
"Tatimi me kuotë fikse (në mijë lekë në vit).

Lloji i biznesitQytetet
Kategoria I Kategoria II Kategoria III
Tregti me pakicë
1. Tregti në njësi e dyqane804030
2. Dyqane mode (boutique) e
parfumeri1508060
3.Dyqane bizhuterie, argjendarie
e floriri2008070
Prodhim
1. Duralumini, druri, tapiceri1506050
2. Bulmet, ëmbëlsirë e të tjera
të ngjashme me to1206050
3. Prodhime brumi 706050
Riparime
1. Riparim artikujsh elektro-
shtëpiakë, radio, televizorë e të
tjera të ngjashme me to 603020
Ç. Shërbime
Fotografim-zhvillim-stampim
e fotokopjim1006050
2. Disko, sallone bukurie, autoservise,
autoshkolla, agjenci të ndryshme,
parkingje makinash, kurse kompjuteri,
salla lojërash, shtypshkrime e të tjera
të ngjashme me to1006050

3. Bar-bufe, kafe-internet1006050
4. Restorant2007050
5. Motel1506050
6. Bar-bufe në dikasteret

dhe institucionet shtetërore604030
7. Bilardo (për një tavolinë)453030
D. Profesione
1. Avokat, noter1507060
2. Klinikë specialitetesh2007060
3.Shërbime stomatologjike individuale,
shërbime laboratori individuale dhe
farmaci individuale 906040
4.Ekonomist kontabël i miratuar,
ekspert kontabël i autorizuar, mësues,
veteriner, agronom, përkthyes e
profesione të tjera706050
5. Inxhinier arkitekt, projektues,2005040
6. Studio arti dhe galeri 353025
7. Shkolla jopublike1109070
DH. Ambulant, artizanat
1.Tregti ambulante151010
2. Artizanë të vegjël si: bojaxhi, hidraulik,
elektricist, lustraxhi, këpucar, marangoz,
pemëtar, berber, zetorist, kombajner, llamarinist
laborant, murator, teneqepunues, riparim
biçikletash e të tjera të ngjashme me to 151010
3. Floktore, rrobaqepësi 151010
4.Në tregje të miratuara nga bashkia
për shitje me pakicë fruta-perime dhe
mallra të përdorura151010
E. Transport
Për transportin e udhëtarëve:
Automjete deri në 5 vende, duke përfshirë edhe shoferin 30 mijë lekë në vit.
Automjete nga 6-9 vende, duke përfshirë edhe shoferin 70 mijë lekë në vit.
Automjete nga 10-25 vende 90 mijë lekë në vit.
Automjete nga 26-42 vende 90 mijë lekë në vit.
Automjetet mbi 42 vende 95 mijë lekë në vit.
Për transportin e mallrave:
Automjete deri në 2 tonë 55 mijë lekë në vit.
Automjete nga 2,1-5 tonë 80 mijë lekë në vit.
Automjete nga 5,1-10 tonë 95 mijë lekë në vit.
Automjete nga 10,1-16 tonë100 mijë lekë në vit.
Automjete mbi 16 tonë150 mijë lekë në vit.
Për transportin ujor:
Transport detar i brendshëm110 mijë lekë në vit.
Transport ujor në liqene 95 mijë lekë në vit.
Varka në shërbim të pushuesve 30 mijë lekë në vit.".

Neni 2

Shkronja "ç" e paragrafit të dytë në nenin 9 ndryshohet si më poshtë:

"ç) Shkeljet e parashikuara në shkronjat "e", "f' dhe "g" të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë në masën 20 mijë lekë, ndërsa shkeljet e parashikuara në shkronjën "ë" të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë 15 mijë lekë kur shkelja bëhet për herë të parë dhe 30 mijë lekë kur shkelja përsëritet.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3200, datë 24.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

**L I G J**
**Nr. 8843, datë 11.12.2001**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8474, DATË 14.4.1999 "PËR MIRATIMIN E NOMENKLATURËS DHE TË TARIFËS DOGANORE", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8558, DATË 22.12.1999 DHE ME LIGJIN NR.8712, DATË 15.12.2000**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8474, datë 14.4.1999 "Për miratimin e nomenklaturës dhe të tarifës doganore", ndryshuar me ligjet nr.8558, datë 22.12.1999 dhe nr.8712, datë 15.12.2000 bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në seksionin I, kapitulli 5 me titull "Produktet me origjinë prej kafshëve të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër", tarifat doganore për kodet 0508, 0509, 0511.91 ndryshohen dhe zëvendësohen me "pa taksë".

Neni 2

Në seksionin III, kapitulli 15 me titull "Vajra, dhjamëra prej kafshëve ose vegjetale dhe produktet e ndarjes së tyre; yndyrna të përgatitura të ngrënshme; dyllet prej kafshëve ose vegjetale", tarifat doganore për kodet 1504, 1511, 1513, 1518 ndryshohen dhe zëvendësohen me "pa taksë".

Neni 3

Në seksionin IV, kapitulli 16 me titull "Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut ose prej krustaceve, prej molusqeve ose prej kafshëve të tjera jovertebrore ujore", tarifat doganore për kodet 16030010, 160411, 160412, 160414, 160415, 160416, 160419, 160420, 160430, 1605 ndryshohen dhe zëvendësohen me "pa taksë".

Neni 4

Në seksionin IV, kapitulli 21 me titull "Përgatitje të ndryshme të ngrënshme", tarifa doganore për kodin 21061080 ndryshohet dhe zëvendësohet me "pa taksë".

Neni 5

Në seksionin IV, kapitulli 23 me titull "Mbetjet dhe kthimet nga industritë ushqimore; tagjia e përgatitur për kafshët", tarifat doganore për kodet 230120, 230250, 2304, 2306 ndryshohen dhe zëvendësohen me "pa taksë".

Neni 6

Në seksionin VI, kapitulli 34 me titull "Sapuni, agjentët organikë me veprim të sipërfaqshëm, preparatet larëse, preparatet lubrifikuese, dyllet artificiale, dyllet e përgatitura, preparatet lustrosëse ose pastruese, qirinjtë dhe artikujt e ngjashëm, pastat modeliste, "dyllet dentare" dhe përgatitjet dentare me bazë allçie", tarifat doganore për kodin 340211 deri në 34021900 ndryshohen dhe zëvendësohen me "2 për qind".

Neni 7

Në seksionin VII, kapitulli 39 me titull "Plastikat dhe artikujt e tyre", tarifat doganore për kodet 39235010, 39235090, 39239090 dhe 39233010 ndryshohen dhe zëvendësohen me "10 për qind".

Neni 8

Në seksionin XV, kapitulli 73, me titull "Artikuj prej gize dhe çeliku", tarifat doganore për kodet 7303 dhe 7322 ndryshohen dhe zëvendësohen me "pa taksë".

Neni 9

Në seksionin XV, kapitulli 74 me titull "Bakri dhe artikujt prej bakri", tarifat doganore për kodin 7411 ndryshohen dhe zëvendësohen me "pa taksë".

Neni 10

Në seksionin XV, kapitulli 76 me titull "Alumini dhe artikujt prej tij”, tarifa doganore për kodin 76129098 ndryshohet dhe zëvendësohet me "10 për qind".

Neni 11

Në seksionin XV, kapitulli 83 me titull "Artikuj të ndryshëm prej metali bazë", tarifa doganore për kodin 83099090 ndryshohet dhe zëvendësohet me "10 për qind".

Neni 12

Në seksionin XVI, kapitulli 84, me titull "Reaktorët nukleарë, bolierat, makineritë dhe pajisjet mekanike; pjesët e tyre", tarifat doganore për kodet 8402 dhe 8403 ndryshohen dhe zëvendësohen me "pa taksë".

Neni 13

Në seksionin XVII, kapitulli 87 me titull "Mjetet e transportit, të ndryshëm nga vagonët e hekurudhës ose tramvajit, pjesët dhe plotësuesit e tyre", tarifat doganore për kodet 87032110, 87032219, 87032211, 87032311, 87032319, 87032410, 87033110, 87033211, 87033219, 87033311, 87033319 ndryshohen dhe zëvendësohen me tarifën doganore prej "2 për qind".

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3201, datë 24.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

**L I G J**
**Nr. 8844, datë 11.12.2001**

## PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8720, DATË 26.12.2000 "PËR KRIJIMIN E POLICISË FINANCIARE", NDRYSHUAR ME AKTIN NORMATIV NR.2, DATË 27.4.2001, MIRATUAR ME LIGJIN NR.8796, DATË 14.5.2001

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8720, datë 26.12.2000 "Për krijimin e Policisë Financiare", ndryshuar me aktin normativ nr.2, datë 27.4.2001, miratuar me ligjin nr.8796, datë 14.5.2001, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 15

Veprimtaria e Policisë Financiare fillon më 1 janar 2003.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3202, datë 24.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

**L I G J**
**Nr. 8845, datë 11.12.2001**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR", NDRYSHUAR ME LIGJET NR.8070, DATË 15.2.1996; NR.8126, DATË 9.7.1996; NR.8130, DATË 22.7.1996; NR.8149, DATË 11.9.1996; NR.8160, DATË 7.11.1996; NR.8186, DATË 23.1.1997; NR.8201, DATË 20.3.1997; NR.8140, DATË 16.9.1997; NR.8445, DATË 21.1.1999; NR.8505, DATË 7.7.1999; NR.8714, DATË 15.12.2000 DHE NR.8779, DATË 26.4.2001**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISE
V E N D O S I:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", ndryshuar me ligjet nr.8070, datë 15.2.1996; nr.8126, datë 9.7.1996; nr.8130, datë 22.7.1996; nr.8149, datë 11.9.1996; nr.8160, datë 7.11.1996; nr.8186, datë 23.1.1997; nr.8201, datë 20.3.1997; nr.8140, datë 16.9.1997; nr.8445, datë 21.1.1999; nr.8505, datë 7.7.1999; nr.8714, datë 15.12.2000 dhe nr.8779, datë 26.4.2001 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 7 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:
"7. Në çastin e çregjistrimit, personi i tatueshëm është i detyruar të paraqesë një formular deklarimi dhe pagese përfundimtare, i cili përmban informacionet që kërkohen nga organi tatimor. ".

Neni 2

Pika 1 e nenit 8 ndryshohet si më poshtë:
"1. Me furnizim mallrash kuptohet transferimi i të drejtës për të zotëruar si pronar pasurinë e luajtshme ose të paluajtshme, përveç rasteve që në këtë ligj përcaktohet ndryshe.".

Neni 3

Pika 1 e nenit 9 ndryshohet si më poshtë:
"1. Me furnizim shërbimesh kuptohet çdo furnizim që nuk është furnizim mallrash, përveç rasteve që në këtë ligj përcaktohet ndryshe. ".

Neni 4

Në pikën 6 të nenit 13 shtohet:
"Në ndërtim fatura tatimore duhet lëshuar çdo muaj.".

Neni 5

Në pikën 2 të nenit 18 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Në rastet e çregjistrimit, të gjitha mallrat e furnizuara për personin e tatueshëm dhe ende në pronësi të personit të tatueshëm, për qëllimet e veprimtarisë së vet ekonomike, dhe të gjitha mallrat

gjendje të personit të tatueshëm trajtohen si furnizim i atyre mallrave kundrejt pagesës në datën e çregjistrimit.".

Neni 6

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 20
**Toka dhe ndërtesat**

1. Furnizimi i tokës dhe i truallit ose dhënia me qira e tyre është një furnizim i përjashtuar, përveç rasteve të shfrytëzimit për parking a magazinim të mjeteve të transportit dhe mjeteve të tjera lëvizëse.
2. Furnizimi i ndërtesave është një furnizim i përjashtuar.".

Neni 7

Pas paragrafit të dytë të pikës 2 të nenit 26 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
"Për importimin e energjisë elektrike nga KESH sh.a. të zbatohet sistemi i shtyrjes së pagesës të TVSH-së, sipas skemës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 8

Pas pikës 6 të nenit 36 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:
"7. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka të drejtë të lejojë mospërdorimin e faturave tatimore me numër serial të parashtypur në rastet kur personi i tatueshëm i regjistruar mund të tregojë, me kërkesë të organeve tatimore, që sistemi i tij i regjistrimeve është i kompjuterizuar dhe i aftë të prodhojë fatura tatimore me numër serial për çdo transaksion të tatueshëm dhe që ka një numër të konsiderueshëm klientësh konsumatorë final".

Neni 9

Pikat 1, 4, 5 e 7 të nenit 42 ndryshohen si më poshtë:
"1. Çdo person, ndaj të cilit është bërë një vlerësim tatimor, në mbështetje të nenit 41, nëse nuk është dakord me vlerësimin tatimor, ka të drejtë të kërkojë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve që vlerësimi tatimor të rishqyrtohet.
4. Me marrjen e kërkesës për rishqyrtim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve fillon rishqyrtimin për vlerësimin ose vlerësimet tatimore të paraqitura për rishqyrtim, përveç rasteve të parashikuara në pikën 5 të këtij neni.
5. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk fillon rishqyrtimin për vlerësimin tatimor për ndonjë person, kur ky person nuk ka bërë të gjitha deklarimet, të cilat është i detyruar t'i bëjë në mbështetje të këtij ligji, si dhe nuk ka paguar TVSH-në e pagueshme prej tij.
7. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton, me shkrim, personin që kërkon rishqyrtimin për rezultatet, duke treguar rishqyrtimin e vlerësimit tatimor dhe datën e rishqyrtimit. " .

Neni 10

Pika 1 e nenit 47 ndryshohet si më poshtë:
"1. Personi i autorizuar nga organi tatimor ka të drejtë të hyjë dhe të kërkojë në çdo vend që përfshin tokë, ndërtesë, automjet, anije, etj., kur ai ka arsye për të besuar që mallrat ose dokumentet e përdorura prej personit të tatueshëm, për qëllimet e zbatimit të këtij ligji, mbahen atje.".

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3203, datë 24.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

**L I G J**
**Nr. 8846, datë 11.12.2001**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8560, DATË 22.12.1999 "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8710, DATË 15.12.2000**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8710, datë 15.12.2000, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 21

Komisioni i Apelimit të Tatimeve
Komisioni i Apelimit të Tatimeve përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët emërohen nga Ministri i Financave. Nga këta, 3 anëtarë përzgjidhen nga Ministri i Financave, 2 anëtarë përzgjidhen mbi bazën e propozimeve të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë në konsultim me shoqatat e biznesit, 1 anëtar mbi bazën e propozimeve të shoqatave të ekonomistëve dhe 1 anëtar mbi bazën e propozimit të Ministrit të Drejtësisë. Anëtarët e Komisionit të Apelimit të Tatimeve të jenë të profesionit ekonomist e jurist. Komisioni i Apelimit të Tatimeve është organ i pavarur pranë Ministrit të Financave dhe i pavarur në vendimmarrje. Ai ka në përbërje të tij edhe një sekretar. Mandati i anëtarëve të Komisionit të Apelimit të Tatimeve është jo më pak se dy vjet, me të drejtë ripropozimi dhe riemërimi. Mënyra e funksionimit të Komisionit të Apelimit të Tatimeve, procedurat e tij operative, procedurat e shkarkimit të anëtarëve dhe mënyra e shpërblimit të tyre përcaktohen me rregullore të nxjerrë nga Ministri i Financave. Komisioni i Apelimit të Tatimeve ka gjithë autoritetin e nevojshëm për të shqyrtuar apelimin e tatimeve, duke përfshirë të drejtën për të kryer hetime dhe rillogaritje të detyrimeve tatimore të përcaktuara".

Neni 2

Pika 3 e nenit 32 ndryshohet si më poshtë:
"3. Organet tatimore kanë të drejtë të çregjistrojnë nga regjistri aktiv i tatimpaguesve çdo tatimpagues, kur provohet se ai për çfarëdo arsye në vitin e fundit fiskal nuk ka ushtruar veprimtari. Në këtë rast, këta tatimpagues mbahen pasivë në një regjistër të veçantë të organeve tatimore".

Neni 3

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 35

Parashkrimi i të drejtës për përcaktimin e detyrimit tatimor

1. E drejta e organeve tatimore për të kontrolluar dhe për të korrigjuar vlerësimin e një detyrimi tatimor, parashkruhet 5 vjet pas lindjes së detyrimit (koha që tatimi duhej të ishte deklaruar ose paguar, cilido qoftë çasti më i fundit në kohë). Afati i parashkrimit ndërpritet në rastet e mëposhtme:

a) Gjatë apelimit të këtij detyrimi;

b) Gjatë kohëzgjatjes së garancisë për këtë pagesë tatimore;

c) Gjatë periudhës në të cilën tatimpaguesi për këtë detyrim është nën një hetim zyrtar në vazhdim, deri në dhënien e një vendimi përfundimtar;

ç) Gjatë periudhës në të cilën tatimpaguesi është i përfshirë në një çështje penale që ka lidhje me këtë detyrim tatimor.

2. Pas çdo ndërprerjeje, afati rifillon që nga çasti i ndërprerjes. Në çdo rast, e drejta për të kontrolluar dhe për të korrigjuar një vlerësim të një detyrimi tatimor, parashkruhet 15 vjet pas lindjes së detyrimit tatimor.

3. Çështjet penale rregullohen sipas afateve të parashkrimit, të parashikuara nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.".

Neni 4

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 36

**Metodat alternative të përcaktimit të detyrimit tatimor**

Organet tatimore mund të rikarakterizojnë transaksionet për të reflektuar situatën ekonomike reale dhe ato mund të mos marrin parasysh formën e transaksionit për të përcaktuar me saktësi përmbajtjen e tij. Rikarakterizimi i transaksioneve bëhet:

a) Kur tatimpaguesi, për një periudhë të caktuar tatimore, nuk ka deklaruar detyrimet e tij tatimore, siç përcaktohet në ligjet e veçanta tatimore.

b) Kur gjatë kontrollit të kryer nga organet tatimore nuk gjendet dokumentacioni i duhur për përcaktimin e detyrimit tatimor, ose kur ky dokumentacion ka mangësi serioze, të cilat nuk lejojnë paraqitjen e situatës reale të tatimpaguesve dhe llogaritjen e detyrimeve të tyre tatimore.

c) Kur tatimpaguesit manipulojnë çmimet e shitjes. Në këtë rast organet tatimore marrin për bazë çmimet reale të tregut.

Rikarakterizimi i transaksioneve për të reflektuar situatën ekonomike reale të një tatimpaguesi mund të bëhet vetëm me urdhër të kryetarit të degës së tatimeve, në bazë të propozimit me shkrim të inspektorëve të grupit të kontrollit. Përcaktimi i detyrimeve në rastet e mësipërme bëhet siç parashikohet në udhëzimin në zbatim të këtij ligji dhe ato përfshijnë përdorimin e koeficientëve teknikë, vlerësimin dhe zhvlerësimin e pasurisë, standardet industriale, numrin e punonjësve, llojin e klientëve, çmimet krahasuese dhe qarkullimin e mallrave të tatimpaguesve të ngjashëm.

Përcaktimi i këtyre treguesve bëhet në mbështetje të ligjeve në fuqi, si dhe në informacionin e dhënë nga shoqatat e specializuara të biznesit.".

Neni 5

Pas nenit 36/3 shtohet neni 36/4 me këtë përmbajtje:

"Neni 36/4

Dispozitat e këtij ligji dhe të gjitha dispozitat e ligjeve të tjera tatimore zbatohen edhe në rastin e ushtrimit të veprimtarive ekonomike, që bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, por që nuk përbëjnë vepër penale.".

Neni 6

Neni 45 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 45

Procedurat e zakonshme të mbledhjes me forcë të detyrimeve

1. Nëse një tatimpagues nuk ka paguar çfarëdo shume të detyrimit tatimor, administrata tatimore, nëpërmjet një urdhri me shkrim i kërkon çdo banke që mban llogari të tatimpaguesit, t'i mbajë këtij të fundit një shumë, që është më e vogla ndërmjet:

a) shumës që, në përputhje me njoftimin, është kërkuar për t'u mbajtur;

b) shumës që, në atë kohë, disponon llogaria bankare e tatimpaguesit.

Shuma që administrata tatimore kërkon të mbahet nga çdo bankë nëpërmjet urdhrit me shkrim, është e para në radhën e pagesave, kur nuk përcaktohet ndryshe me një ligj tjetër.

2. Kur banka nuk mban shumën e kërkuar sipas pikës 1 të këtij neni, atëherë ajo i paguan organit tatimor një penalitet në masën 0,2 për qind në ditë për shumën e detyrimit të pambajtur.

3. Një kopje e çdo njoftimi të bërë sipas paragrafit 1 të këtij neni, do t' i jepet edhe tatimpaguesit.

Neni 7

Pas nenit 46 shtohet neni 46/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 46/1

E drejta e hyrjes dhe e inspektimit

Personi i autorizuar nga organi tatimor mund të hyjë dhe të kërkojë në çdo vend që përfshin çdo tokë, ndërtesë, automjet, anije etj., kur ai ka arsye për të besuar që mallrat ose dokumentet e përdorura prej personit të tatueshëm për qëllimet e zbatimit të këtij ligji mbahen atje.

Personi i autorizuar nga organi tatimor, që hyn në mjediset e biznesit të tatimpaguesit, i inspekton ato duke kërkuar çdo dokument, gjendjen e mallrave etj. Ai mund të inspektojë dhe të marrë kopje të çdo llogarie, regjistrimi ose dokumenti. Ai mund të inspektojë dhe të kontrollojë, gjithashtu, edhe operimet me kompjuter, arka regjistruese ose pajisje të tjera, si dhe të marrë kopje të çdo llogarie, regjistrimi ose informacioni tjetër të mbajtur nëpërmjet këtyre mjeteve.".

Neni 8

Pas nenit 46/1 shtohet nenit 46/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 46/2

Parashkrimi i detyrimeve të papaguara

1. Afati i parashkrimit të një detyrimi tatimor të papaguar është 6 vjet nga data kur vlerësimi tatimor i është njoftuar zyrtarisht tatimpaguesit. Afati i parashkrimit ndërpritet në rastet e mëposhtme:

Gjatë apelimit të këtij detyrimi;

Gjatë kohëzgjatjes së garancisë për këtë pagesë tatimore;

c) Gjatë periudhës në të cilën tatimpaguesi është nën një hetim zyrtar në vazhdim, për këtë detyrim, deri në dhënien e një vendimi përfundimtar;

ç) Gjatë periudhës në të cilën tatimpaguesi është i përfshirë në një çështje penale që ka lidhje me këtë detyrim tatimor.

2.Pas çdo ndërprerjeje, afati rifillon nga çasti i ndërprerjes. Në çdo rast, e drejta për të mbledhur një detyrim tatimor të papaguar, parashkruhet 15 vjet nga data kur vlerësimi tatimor i është njoftuar zyrtarisht tatimpaguesit.”.

Neni 9

Pas nenit 50 shtohet neni 50/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 50/1

**Shkeljet dhe dënimet për klientët**

Kushdo që blen mallra e shërbime është i detyruar të kërkojë e të pajiset me dokumentin e blerjes, që mund të jetë faturë TVSH-je, faturë e thjeshtë ose kupon tatimor (i lëshuar me arkë regjistruese). Mospasja e këtyre dokumenteve:

1. Nga ana e blerësve individë, dënohet me gjobë me vlerë 500 lekë.
2. Nga ana e blerësve që janë tatimpagues të biznesit të vogël, dënohet me gjobë me vlerë 20 mijë lekë.
3. Nga ana e blerësve që janë tatimpagues të regjistruar në TVSH-në, si dhe në çdo rast tjetër, dënohet me gjobë me vlerë 30 mijë lekë.".

Neni 10

Neni 52 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 52

**Shkeljet dhe dënimet për mosdokumentim**

Ruajtja, përdorimi dhe transportimi i mallrave pa dokumentacionin e përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave, kur nuk është përcaktuar ndryshe në këtë ligj dhe në ligjet e veçanta tatimore, dënohet me gjobë nga 30 deri në 50 mijë lekë.".

Neni 11

Neni 54 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 54

**Shkeljet dhe dënimet penale**

Shkeljet që përbëjnë vepër penale, përveç dënimeve administrative të përcaktuara në këtë ligj dhe në ligje të tjera tatimore, dënohen edhe penalisht, në përputhje me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.".

Neni 12

Pas nenit 64 shtohet neni 64/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 64/1

**Stimujt për kontrollet e organeve tatimore**

Të ardhurat që burojnë nga zbulimet e kryera nga organet tatimore, por dhe që janë arkëtuar, shpërndahen si vijon:

a) 80 për qind për Buxhetin e Shtetit, në llogaritë përkatëse të të ardhurave tatimore;

b) 20 për qind për organet tatimore, nga të cilat 5 për qind e tyre u jepet informatorëve për informacionet e dhëna, që çojnë në zbulimin e të ardhurave tatimore. Për çdo rast, informimi bëhet me shkrim. Nëse nuk ka pasur informatorë të tillë, ky 5 përqindësh i vihet në përdorim kryetarit të degës së tatimeve dhe përdoret sipas udhëzimeve të Ministrit të Financave.".

Neni 13

Pas nenit 66 shtohet neni 66/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 66/1

Detyrimi i bankave për të dhënë informacion për numrin e llogarisë së subjekteve tatimpaguese pa kërkesën e organeve tatimore

Bankat dhe filialet e tyre në rrethe janë të detyruara të njoftojnë organet tatimore për llogaritë e hapura dhe për ato që do të hapen të tatimpaguesve. Njoftimi bëhet një herë në tri muaj për të gjitha llogaritë e hapura dhe të mbyllura gjatë tremujorit përkatës. Ai përmban emrin ose emrin tregtar të tatimpaguesit, numrin dhe datën e llogarisë së hapur, si dhe numrin dhe datën e llogarisë së mby1lur. Njoftimi i parë, që bankat bëjnë për organet tatimore, përfshin të gjithë periudhën e mëparshme, pavarësisht nga koha kur llogaria është hapur.".

Neni 14

Në nenin 67 bëhen këto ndryshime:

Fjalia e parë e paragrafit të parë ndryshohet si më poshtë:

"Organet tatimore mund të kërkojnë informacione nga palët e treta, me qëllim përcaktimin e detyrimit të çdo tatimpaguesi.".

Pas shkronjës "g" shtohet shkronja "h" me këtë përmbajtje:

"h. Donatorët e ndryshëm për fondet e livruara tatimpaguesve, përkundrejt furnizimit të mallrave ose shërbimeve që ato kryejnë me këto fonde.".

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3204, datë 24.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

# L I G J
# Nr. 8847, datë 19.12.2001

## PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2002

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

### KREU I
### BUXHETI I SHTETIT

Neni 1

Fondi i konsoliduar për vitin 2002 është:
Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit.........131 939 milionë lekë
Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit..........187 566 milionë lekë
Deficiti 55 627milionë lekë
Fondi i konsoliduar përbëhet:
Buxheti qendror
Të ardhurat............128 939 milionë lekë
Shpenzimet.........................184 566 milionë lekë
Buxheti i pavarur i pushtetit vendor
1. Të ardhurat ...........................12 500milionë lekë
Nga të cilat:
Granti nga buxheti qendror 9 500milionë lekë
2. Shpenzimet 12 500milionë lekë

Neni 2

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2002 është:
Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror
Të ardhurat gjithsej.....34 632 milionë lekë
- Nga kontributet....24 019 milionë lekë
- Transferimet nga Buxheti i Shtetit10 613milionë lekë
Shpenzimet.....34 632milionë lekë

Paga minimale për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore deri në rritjen e pagave është 8396 lekë në muaj. Pas rritjes së pagave, Këshilli i Ministrave përcakton pagën e re.

Skema e sigurimit suplementar
Të ardhurat gjithsej.... 1 468 milionë lekë
- Nga kontributet 32milionë lekë
- Transferimet nga Buxheti i Shtetit1 436milionë lekë
Nga të cilat:
Për sigurimin suplementar të ushtarakëve 964 milionë lekë

Sigurimet suplementare shtetërore 108milionë lekë
Pagesat e parakohshme për minatorët 364milionë lekë
Shpenzimet..... 1 468milionë lekë

Neni 3

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2002 është:
Të ardhurat gjithsej3 836milionë lekë
- Nga kontributet1 956milionë lekë
-Të tjera 80 milionë lekë
-Transferimet nga Buxheti i Shtetit1 800milionë lekë
Shpenzimet3 836milionë lekë

## KREU II
## BURIMET PËR MBËSHTETJEN E SHPENZIMEVE BUXHETORE

Neni 4

Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit sipas grupeve kryesore janë:

Të ardhurat tatimore109 800 milionë lekë
Të ardhurat jotatimore19 139milionë lekë
Të ardhurat e buxhetit vendor3 000milionë lekë

Neni 5

Kufiri maksimal i financimit të deficitit të buxhetit të përgjithshëm nga burime të brendshme është 27 216 milionë lekë, nga i cili 11 153 milionë lekë financohet nga të ardhurat e privatizimit. Në rast të mosrealizimit të të ardhurave nga privatizimi, huamarrja për financimin e deficitit të brendshëm nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve. Kufiri i financimit nga burimet e huaja është 28 411 milionë lekë, nga i cili mbështetje e drejtpërdrejtë për deficitin është 5 211 milionë lekë.

Neni 6

Disbalancimi i mundshëm gjatë vitit i buxhetit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore financohet nga fondi i garantimit të pensioneve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe fondi rezervë i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

## KREU III
## SHPENZIMET E BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 7

Shpenzimet sipas drejtimeve kryesore janë:
- Shpenzimet korrente.............129 515milionë lekë
- Shpenzimet kapitale ............. 52 751 milionë lekë
- Rezerva e Këshillit të Ministrave 3 300milionë lekë
- Kontingjenca ......... 2 000milionë lekë

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, i ndarë në fonde të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara, është sipas tabelës 1 të bashkëngjitur.

Neni 8

Numri maksimal i punonjësve buxhetorë mbi të cilin është përgatitur Buxheti i Shtetit i vitit 2002 është 110 500 punonjës më 1 shkurt 2002. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë numrin e punonjësve buxhetorë për çdo ministri dhe institucion qendror. Fondi për rritjen e pagave prej 2400 milionë lekë përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me politikat e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 9

Shpenzimet kapitale nga burimet e brendshme janë 26 251 milionë lekë dhe nga burime të huaja 26 500 milionë lekë.

Investimet sipas ministrive dhe institucioneve paraqiten në tabelën 2 të bashkëngjitur.

Neni 10

Fondi i kontingjencës prej 2 000 milionë lekësh do të përdoret:

- Për ruajtjen e deficitit, me miratim të Kuvendit 1000 milionë lekë.
- Me vendim të Këshillit të Ministrave, 1000 milionë lekë për rritjen e investimeve në zërat TVSH, taksë doganore, kosto lokale dhe shpronësime, në përputhje me ecurinë e financimeve të huaja, në rast se fondet e akorduara për këtë qëllim, sipas tabelës 2, nuk janë të mjaftueshme.

Neni 11

Në fonde të kushtëzuara përfshihen shpenzimet për investime me burim financimet e huaja dhe shpenzimet nga të ardhurat që me ligj ose me akte të tjera nënligjore i përkasin ministrive dhe institucioneve të tjera buxhetore. Fondet e kushtëzuara, me përjashtim të financimeve të huaja, përdoren brenda vitit buxhetor.

Neni 12

Fondet buxhetore për pushtetin gjyqësor paraqiten sipas tabelës 3. Buxheti i pushtetit gjyqësor administrohet nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, në bazë të ligjit nr.8363, datë 1.7.1998. Bordi i Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor mund të rishpërndajë deri në 10 për qind të totalit të fondeve për çdo nivel të pushtetit gjyqësor, si dhe të miratojë çdo transferim midis gjykatave të të njëjtit nivel, duke respektuar raportet midis shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale, paraqitur në tabelën 3.

Neni 13

Transferta e pakushtëzuar që buxheti qendror i transferon pushtetit vendor, përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe funksioneve, që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transferta e pakushtëzuar përfshin edhe të ardhurat nga tatimi mbi biznesin e vogël prej 2 800 milionë lekësh. Çdo tejkalim i të ardhurave nga ky tatim mbi shumën e përcaktuar më sipër përdoret nga organet e pushtetit vendor në të njëjtin raport me shpërndarjen fillestare të transfertës së pakushtëzuar. Buxheti i Shtetit siguron financimin e plotë të transfertës së pakushtëzuar në shumën e përcaktuar në këtë ligj edhe në rast të mosrealizimit të të ardhurave nga tatimi mbi biznesin e vogël.

Transferta e pakushtëzuar shpërndahet midis organeve të pushtetit vendor sipas formulës në aneksin nr.1 bashkëngjitur. Fondi rezervë nga totali i transfertës së pakushtëzuar, si dhe granti barazues përdoret nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministria e Financave sipas kritereve të përcaktuara në aneksin nr.2 bashkëngjitur. Shuma e transfertës së pakushtëzuar për çdo organ të pushtetit vendor është në tabelën nr.4.

Fondet që sipas këtij neni u vihen në dispozicion organeve të pushtetit vendor, fondet e tjera që me akte të tjera ligjore dhe nënligjore u kalojnë organeve të pushtetit vendor, si dhe vendimet e këshillave të organeve të pushtetit vendor, që kanë lidhje me përdorimin e fondeve buxhetore, bëhen publike.

Neni 14

Kufiri i shpenzimeve, sipas tabelave 1 dhe 2, mund të rishpërndahet gjatë vitit midis ministrive dhe institucioneve nga Këshilli i Ministrave, deri në masën 10 për qind të totalit të fondeve të miratuara për çdo ministri dhe institucion.

Neni 15

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit, si dhe atij të garantuar të shtetit në dobi të palëve të treta përfituese është si më poshtë:

1. Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit, si rezultat i zbatimit të buxhetit të vitit 2002, është 39 563 milionë lekë, nga i cili:

- Për kreditë e jashtme të drejtpërdrejta të Këshillit të Ministrave është 23 500 milionë lekë.
- Për financimin e brendshëm të deficitit buxhetor me bono thesari është 16 063 milionë lekë.

2. Kufiri për rritjen vjetore të garancive të shtetit në dobi të palëve të treta përfituese është 5 300 milionë lekë.

3. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra të jashtme të papaguara është 10 800 milionë lekë.

Neni 16

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 17

Çdo akt ligjor që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.3208, datë 26.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

## L I G J
## Nr. 8848, datë 19.12.2001

## PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8437, DATË 28.12.1998 "PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJET NR.8507, DATË 7.7.1999, NR.8595, DATË 6.4.2000 DHE NR. 8716, DATË 15.12.2000

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1 dhe 155 të Kushetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8437, datë 28.12.1998 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr.8507, datë 7.7.1999; nr. 8595, datë 6.4.2000 dhe nr.8716, datë 15.12.2000, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:
1. Pika "C" ndryshohet si më poshtë:
"C. Pije joalkoolike, freskuese e të tjera3 000 lekë për 1000 litra".
2. Pika "D" ndryshohet si më poshtë:
"D. Kafe
- Kafe e papjekur33 000 lekë për 1000 kg
- Kafe e pjekur e bluar ose jo78 000 lekë për 1000 kg.".

Neni 2

Pas nenit 3 shtohet 3/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 3/1

Importuesit, prodhuesit dhe tregtarët me shumicë të mallrave me akcizë, regjistrohen si tregtarë të mallrave me akcizë në organet tatimore.".

Neni 3

Pas paragrafit të parë të nenit 4, shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:
"Për birrën e prodhuar në vend, llogaritja e akcizës bëhet duke zbatuar mbi sasinë e birrës së prodhuar dhe të deklaruar, përqindjen e akcizës së përcaktuar në nenin 3 të ligjit "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë". Sasia e birrës së deklaruar korrigjohet në rritje, në përpjesëtim të barabartë me masën e tejkalimit të kufirit teknik maksimal të lejueshën të rezes së maltos së përdorur mbi 20 kg për 100 litra birrë të prodhuar.
Tatimpaguesit e regjistruar për prodhimin e birrës ose për importimin dhe tregtimin e maltos, si lëndë e parë për prodhimn e birrës, detyrohen të paguajnë 294 lekë akcizë për kilogram malto të llogaritur në rastet e shitjes së maltos personave të paregjistruar për prodhimin e birrës ose të përdorimit të saj për qëllime të tjera.".

Neni 4

Shkronja "a" e nenit 5 ndryshohet si më poshtë:
"a) Për mallrat e prodhuara në vend,, kur detyrimi nuk paguhet nëpërmjet blerjes së pullës fiskale, akciza llogaritet në çastin e lëvizjes së mallrave nga vendi i prodhimit, dhe deklarohet e paguhet për periudhën 1-15 të muajit brenda 20 të muajit, ndërsa për periudhën 1-31 të muajit deri më datën 5 të maujit pasardhës.".

Neni 5

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Akciza paguhet për importimin dhe prodhimin brenda vendit të mallrave që i nënshtrohen akcizës. Akciza paguhet gjithashtu edhe për mallrat e prodhuara në vend, të cilat prodhohen me lëndë të importuara, që i nënshtrohen akcizës në çastin e importimit.

Importuesit, prodhuesit dhe tregtuesit me shumicë të mallrave, që i nënshtrohen akcizës, për të gjitha shitjet që kryejnë, detyrohen të identifikojnë në faturat tatimore të shitjes emrin, NIPT-in dhe kodin fiskal të tatimpaguesit blerës.”.

Neni 6

Pas pikës 4 të nenit 9 shtohen pikat 5, 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“5. Importimi, prodhimi, ruajtja, livrimi ose shitja e mallrave, akciza e të cilave paguhet nëpërmjet pullave fiskale, pa blerë këto pulla.

6. Importimi, prodhimi, ruajtja, livrimi ose shitja e mallrave të tatueshme me akcizë, pa u regjistruar në oragnet tatimore.

7. Mbajtja, me qëllim shitjeje ose konsumi, e mallrave të tatueshme me akcizë, duke njohur që akciza mbi këto mallra nuk ka qenë paguar.”.

Neni 7

Në nenin 10 shtohen paragrafët si më poshtë:

“ – Importimi, prodhimi, ruajtja, livrimi ose shitja e mallrave, pa pullat fiskale, në rastin kur akciza e tyre paguhet nëpërmjet pullave fiskale, përveç pagimit të shumës së akcizës që lidhet me sasinë e mallit pa pullë fiskale, dënohet edhe me konfiskimin e tyre.

- Importimi, prodhimi, ruajtja, livrimi ose shtija e mallrave të tatueshme me akcizë, pa u regjistruar në organet tatimore, përveç pagimit të shumës së akcizës që duhej paguar, dënohet edhe me konfiskimin e tyre.

- Mbajtja, me qëllim shitjeje ose konsumi, e mallrave që i nënshtrohen akcizës, duke ditur që akciza mbi këto mallra nuk ka qenë paguar, përveç pagimit të shumës së akcizës që lidhet me sasinë e mallit pa pullë fiskale, dënohet edhe me konfiskimin e tyre.”.

Neni 8

Pas nenit 13 shtohet neni 13/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 13/1

Për firot, që ndodhin gjatë procesit të përpunimit dhe prodhimit të produkteve, zbritja lejohet në kufijtë e firove teknikisht të pranueshme, të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe ministria përkatëse.”.

Neni 9

Ky ligj hyn 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3207, datë 26.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 26.12.2001
Doli nga shtypi më 26.12.2001

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 4230 copë | Formati: 60x88/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001

Çmimi: 150 lekë